



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr _____ Prot

Pogradec me 18.09.2023

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS -- PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstrukcion Sallë pritje për të moshuarit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45000000-7 (Punë ndërtimi); 45210000-2 (Punime ndërtimi)

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,499,404 (dy milion katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e katër) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. . Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertës sipas Shtojcës 1.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit (2020, 2021 dhe 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, germa (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe viti 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 30% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet** dhe që është **realizuar gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje

- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55 pika 4 germa a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 55, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme dhe speciale të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
- N.P - 2 A “Ndërtime civile e industriale”
- N.S – 8 A “Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së

licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një),

i cili duhet të figurojë në Listëpagesa të pakten për periudhën Qershor - Gusht 2023, për të cilin duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diploma përkatëse.

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara publikimit të njoftimit të fituesit operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kerkesa per drejtuesin teknik “Inxhinier Ndertimi” Eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier,Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion ing ndertimi i cili do te jete pergjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej (14) persona për periudhën Qershor - Gusht 2023, e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Qershor - Gusht 2023.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor - Gusht 2023.

Shënim: *Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet:“Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qenia e tyre në listepagesa, tregojnë besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 14 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit,

matjeve përkatëse është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. *Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).*

Nr.	Nr. An	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	OP	OP TOTAL
A		PUNIME PRISHJE				
1	An/1	Heqje dyer + Dritare + transport	m ²	37.4	2.04	76.3
2	An/2	Prishje suvatimi ne mure+tavane+trans mbet.	m ²	216.0	1.4	302.4
3	2.426/3	Prishje shtresa betoni poshte pllakave te dysh.	m ³	7.0	18.8	131.6
4	An/3	Prishje shtrese me pllaka + transport mbeturin.	m ²	66.8	0.9	57.0
5	2.426/1	Prishje mur tullë me pastrim	m ³	7.0	2.2	15.4
6	2.37/5b	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	m ³	18.5	0.4	7.4
B		PUNIME SUVATIMI + SHTRESA BRENDA				
1	2.300.	Suvatim solete h-4m,me drejtues me krah	m ²	66.8	2.9	190.4
2	2.262/3	Shtresë betoni C 12/15	m ³	2.7	8.6	23.2
3	2.310.	Suva brenda mure tulle h-4m, me krah, llac perzier M25	m ²	156.0	1.6	241.8
4	2.276	Shtresë parketi laminat	m ²	55.4	4.7	260.4
5	2.267/1	Shtresë me pllaka porcelanat importi	m ²	11.3	2.0	22.6
6	2.33	Patinim tavani allçi (stuko)	m ²	66.8	1.0	66.8
7	2.326	Veshje me Pllakë majolike	m ²	25.0	3.7	92.5

						0.0
C		PUNIME DYER - DRITARE				0.0
1	2.395/a	Dyer d/alumini dopio xham.	m ²	8.6	2.4	20.6
2	2.375/1	F.V. dritare d/alumini plastike me dopio xham	m ²	28.8	2.2	63.4
D		PUNIME HIDROSANITARE				
1	2.501	F.V WC allafrenga importi	cope	2.0	3.7	7.4
2	2.495	FV lavaman porcelani me miselator imp.	cope	2.0	3.0	5.9
3	An/4	Pasqyrë me llambë LED, Luce, 70x90 cm	cope	1.0	0.3	0.3
4	2.515	F.V piletë dysHEMEJE Ø 50 mm	cope	2.0	3.7	7.4
5	2.491/a	F.Tubo e rakorderi IPE =20mm t=2.0mm PN10	ml	20.0	0.3	6.0
6	2.494/1	FV saracineske bronxi 3/4"=20mm	cop	6.0	1.2	7.2
E		PUNIME BOJATISJE+MURE				
1	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilësi e l-re	m ²	156.0	0.4	56.2
2	2.71/1	Mur me tullë të lehtësuara dopio deri 8m me llaç përzier M 15	m ³	4.3	18.6	80.0
						0.0
F		PUNIME ELEKTRIKE				0.0
1	480/1	Tuba plastike Ø 14-17mm	ml	30.0	0.3	9.6
2	2.481/1	Furniz.vendosje percjellsa Pv-500 1.5mm ²	ml	90.0	0.0	3.6
3	2.481/2	Furniz.vendosje percjellsa Pv-500 2.5 mm ²	ml	90.0	0.0	3.6
4	2.483	Furniz.vendosje celsa dhe priza	cop	20.0	1.0	20.0

		10A				
5	2.489	Furniz.vendosje siguresa 25A	cop	5.0	0.3	1.5
6	2.483	Furnizim.Vendosje çelsa +priza 10A me nulifikim	cop	5.0	1.0	5.0
7	2.486	FV portollamba normale 10A	cop	8.0	0.6	4.4
8	2.489	FV siguresa 25A	cop	3.0	0.3	0.9
9	2.490.a	FV .automat 4 vende	cop	2.0	2.1	4.2
10	2.490/b	FV kasete plastikeme 6vende	cop	1.0	1.5	1.5
11	2.a-135	FV ndricues tip spote	cop	16.0	1.2	19.2
G		PUNIME TE NDRYSHME				
1	An/5	Grilë veneciane, e bardhë + montim	m ²	37.0	3.2	118.4
2	An/6	Tavoline drejtkendore SUMATRA, E zezë, Polipropilen, 138x78x72 cm	cop	7.0	0.2	1.1
3	An/7	Karrige bari, këmbë metalike (zezë), tapiceri tekstili, gri, 52x50.5xH75 cm	cop	21.0	0.2	4.4
4	An/8	Vazo lulesh, M, pjatë e përfshirë, Milan, qeramike, jeshile, Ø24 xH21 cm + lule	cop	3.0	0.1	0.3
5	An/9	Mulli MiniMoka 9994000000	cop	1.0	0.3	0.3
6	An/10	Ekspres Sage Appliances SES878BSS	cop	1.0	0.3	0.3
7	An/11	Banak lokali + montim	cop	1.0	11.0	11.0
8	An/12	Lavapjatë, 2 gropa, inoks, argjendi, 86x50xH22.5 cm + montim	cop	1.0	2.0	2.0
9	An/13	Loje shahu, Domino, Tavell	cop	10.0	0.1	0.8
10	An/14	Gotë uji Royal 33.5cl (pk12), Përmasa: 7xH14.5cm, Ngjyra Transparente, Material: Qelq	cop	40.0	0.1	4.0

11	An/15	Filxhan Alfa, qeramikë, e zezë, 11cm / 360cc	cop	40.0	0.1	4.0
12	An/16	Filxhan kafe, qeramik, e bardhe	cop	40.0	0.1	4.0
13	An/17	Luge Kafe MILORD, Permasa: 10.4 cm, Ngjyra: Argjendi, Materiali: Inoks	cop	40.0	0.1	4.0
14	An/18	Ngrohës uji BOSCH, 1500 W, 10 Lt, i lartë, Tronic 2000, 8- 70°C, 8 bar, 1/2 ", 230V/50 Hz, 25x41x37 cm, 7 kg	cop	1.0	2.0	2.0
15	An/19	Televizor LED, Philips, 55", 4K UHD 3840 x 2160 @60 Hz , Smart Saphi, HDR10/HLG, DVB-T/T2/T2-HD/C/S/S2, 3xHDMI, 2xUSB, Wi-Fi 802.11n, 2 x 2, Single band	cop	1.0	0.9	0.9
16	An/20	FRIGORIFER ECOLUX SDS 385 DC	cop	1.0	0.2	0.2
17	An/21	KONDICIONER SAMSUNG AR24TXHZAWKNEU	cop	1.0	3.5	3.5

Ore pune total	1976.8	ore
Per 1 puntor	247.10	dite
Sp. + Punetore	11.2	
1-Kamioncine mbi 3.5 ton	2	cop

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Pllakashtrues 2 (dy)
- Suvatues 2 (dy)
- Bojaxhinj 1 (nje)
- Hidraulik 1 (nje)
- Elektracist 1 (nje)
- Punetore te Thjeshte 4 (kater)

të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në

Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë të pakten për periudhën Qershor – Gusht 2023.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar minimalisht 2 (dy) shofere.

Per shoferet te paraqitet leje drejtimi e vlefshme dhe te figurojne ne listepagesa te pakten për periudhën Qershor - Gusht 2023, ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të kontraktohen, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Shenim. Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet:“Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetes është llogaritur në baze të zberthimit të grafikut të punimeve dhe zberthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej **14 personash** përfshin personelin kryesor, drejtues teknik, stafin mbështetes dhe numrin e punëtorëve të thjeshtë përlllogaritur nga zberthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushës rezulton se:

Sasia e oreve të punës sipas manualit dhe analizave teknike është **1976,8 ore**. Llogaritja e numrit të punonjësve në varesi të oreve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë

Totali orë pune	1976,8
Orë pune / 8	247
Nr. i punëtorëve (ditë pune/22 ditë)	11
Shofere / 2	13

Drejtuesi teknik, Ing ndertimi	1
Numri i punëtorëve gjithsej	14

2.3.6 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Emertimi	Njesia	Sasia	Statusi
Autoveteshkarkues mbi 3.5 ton	Cope	2	Në pronësi ose me qera
Betoniere 500L	Cope	1	Në pronësi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën, dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), Certificate transporti për përdorim për vetë dhe nga të tretet, sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot, datë 14.07.20, sipas të cilit mjetet me qera nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretet.
- Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- Mjetet dhe pajisjet teknike të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.8.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e

objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike: Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisës së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv .

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatën:

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë), e vlefshme

Certifikata ISO duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

SHËNIM: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.....*

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), brenda

afatit 5 (pesë) ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Teritorrit, pjese perberese e struktures se Bashkise Pogradec, qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderate kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar sebashku me dokumentat e tenderit.

Njesia e Prokurimit: